



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
DIREKCIJA ZA POLJOPRIVREDU I RURALNI RAZVOJ
DIRECTORATE FOR AGRICULTURE AND RURAL DEVELOPMENT

Data/Datum/Date:	29.04.2025
Nr./Br./No	12/13
Nga/Od/From:	Drejtore i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gojart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Thirrje për aplikim

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale neni 61 paragrafi 62.3, Rregullores Nr.01-060/01-24495/17 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve neni 5 paragrafin 5.1 dhe 5.2, neni 19 paragrafi 19.1, 19.1.3 dhe 19.2.4, drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, bënë këtë:

Thirrje për aplikim

Furnizimi me Serra bujqësore për kultivim të perimeve, me sipërfaqe 0.5 ari (50m²)

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret si:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Shtimës,
- Të ketë mundësi për ta realizuar projektin,
- Të ketë përshtatshmëri të vendit për realizimin e projektit në afërsi të shtëpisë,
- Të ketë ujë të mjaftueshëm për ujitje.

Në kushte të barabarta përparësi do të kenë:

- Familjet që nuk kanë përfituar tri vitet e fundit subvencione nga DBZHR
- Familjet me gjendje të vështirë ekonomike,
- Familjet me anëtar që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike apo invaliditet
- Femrat kryefamiljare

Dokumentat obligative për aplikim:

- Kopja e ID (letërnjoftimi) të Republikës së Kosovës,
- Çertifikata e bashkësisë familjare,
- Çertifikata për pronësi të tokës (Fletën poseduese) orgjinal
- Konfirmimin e të ardhurave nga banka (pasqyra bankare për periudhën kohore; 6 muajt e fundit)
- Dëshmia e pagesës së tatimit në pronë,
- Fletëaplikacioni i plotësuar (merret dhe dorëzohet në zyrën e shërbimit me qytetar).

Aplikacionet me informata të pa sakta, të pa plotësuara dhe të pa kompletuara do të refuzohen.

Afati për aplikim: 29 Prill 2025 – 13 Maj 2025

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse (sportelet e administratës)